

LIGJ
Nr.9313, datë 11.11.2004

PËR PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, TË BANKËS
ITALO-SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ministria e Financave, me cilësinë e pronarit, lejohet, në emër të shtetit shqiptar, të transferojë të drejtën e pronësisë nëpërmjet shitjes së 40 për qind të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare.

Neni 2

1. Aksionet, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare, t'u ofrohen për shitje, fillimisht, aksionerëve të kësaj banke, sipas legjislacionit në fuqi dhe aktit të themelimit të saj.

2. Në rast se edhe aksionerët e tjerë vendosin transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të tyre, të kësaj banke, procedura për shitjen e tyre të bëhet sipas marrëveshjes së aksionerëve, e cila, për pjesën e aksioneve të shtetit shqiptar, miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

1. Transferimi i të drejtës së pronësisë të këtyre aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare, për rastet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, të kryhet vetëm pas vlerësimit të çmimit të aksioneve nga një vlerësues i njohur ndërkombëtar.

2. Përzgjedhja e vlerësuesit ndërkombëtar në rastin e pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, të bëhet me tender të hapur ndërkombëtar, ndërsa në rastin e pikës 2 të po këtij neni të bëhet sipas marrëveshjes së aksionerëve.

Neni 4

1. Nëse shitja e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare nuk realizohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave ka të drejtën t'ia shesë ato, nëpërmjet tenderit të hapur, një investitori strategjik të njohur në sektorin bankar, i cili ofron garanci financiare.

2. Procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Përcaktimi i vlerës së aksioneve për fillimin e procedurave të tenderit, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji, bëhet pas vlerësimit të aksioneve të Bankës Italo-Shqiptare nga një vlerësues ndërkombëtar, i përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar.

Neni 6

Këshilli i Ministrave miraton vlerën e aksioneve, të përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, sipas parashikimeve të nenit 3 pika 1 dhe të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 7

1. Të ardhurat që sigurohen nga privatizimi i aksioneve të kësaj banke derdhen në Buxhetin e Shtetit pasi të jenë zbritur shpenzimet që do të përdoren për realizimin e procesit të shitjes, të cilat nuk duhet të kalojnë shumën 10 për qind të vlerës së shitjes.

2. Kriteret për përdorimin e shumës deri në 10 për qind të vlerës së shitjes, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4415, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Aldred Moisiu